


1827/26 28-04-2026



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 28.04.2026, merr këtë:

### VENDIM NR.19/2026/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 01.04.2026

#### Neni 1


Miratohet procesverbali nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 01.04.2026.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 01.04.2026.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević



## PROCESVERBALI

Nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 01.04.2026 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe fillo me punë në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm 16 nga 19 këshilltarë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë 3 këshilltarë: Marija Steviq, Lumnije Gashi dhe Albert Vllahu. Në mbledhje janë të pranishëm: përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, shefi i Kabinetit, drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjeve Kadrovike, drejtori i Drejtorisë së Kadastrës, mediat, Shërbimi për Informim, Shërbimi për Përkthim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi këshilltarët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti e dha njëzëri mendimin pozitiv për rendin e ditës të caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit tha se në bazë të nenit 44 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 është caktuar rendi i mëposhtëm i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e rregullt, e mbajtur më datën 11.03.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për dhënien e autorizimit kryetarit të komunës për fillimin e konsultimeve dhe hartimin e propozim-marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2025, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq (*Zorica Milić*).
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Drejtorisë së Kadastrës për periudhën nga 01.01.2025 deri më 31.12.2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Kadastrës, Jovan Mirkoviq (*Jovan Mirković*).
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për

vitin 2025, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës dhe realizimit të planit të punës së KK të Graçanicës për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).

8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e rregullt, e mbajtur më datën 11.03.2026.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 këshilltarëve "Pro", miratoi pikën e parë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).

Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjeve Kadroviqe, Vlladica Trajkoviq, tha se duke u bazuar në takimet e mbajtura në mes të Komunës së Graçanicës dhe të Lepsaviqit, kanë pranuar një kërkesë për fillimin e procedurës për bashkëpunimin ndërkomunal, e cila është në përputhje me Ligjin. Komuna e Graçanicës e mbështeti kërkesën e tyre sepse, për shkak të ndryshimeve që ndodhën në Komunën e Lepsaviqit, ata hasën në probleme lidhur me funksionimin e tyre. Meqenëse Komuna e Graçanicës funksionon që nga viti 2010, vendosëm ta ndihmojmë në periudhën e nevojshme, derisa shërbimet të bëhen funksionale në Komunën e Lepsaviqit. Ata e kaluan procedurën përmes Kuvendit të tyre, ndërsa ne sot duhet ta miratojmë Vendimin për fillimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 këshilltarëve "Pro", miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për dhënien e autorizimit kryetarit të komunës për fillimin e konsultimeve dhe hartimin e propozim-marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).

Kryesuesi shpjegoi se Kuvendi i Komunës së Lepsaviqit e miratoi Vendimin për dhënien e pëlqimit për fillimin e procedurës për lidhjen e Marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Graçanicës. Pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, ata i dërguan një kërkesë Komunës së Graçanicës për fillimin e procedurës për lidhjen e Marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 këshilltarëve "Pro", miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2025, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milić (*Zorica Milić*).

Kryesuesi i njoftoi këshilltarët se drejtoresha kishte treguar se nuk është në gjendje të merrte pjesë në mbledhje dhe duke qenë se është praktikë që raportet e drejtorive të shpjegohen nga vetë drejtorët në mënyrë që këshilltarët t'i marrin përgjigjet e sakta ndaj pyetjeve të tyre, kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Drejtorisë së Kadastrës për periudhën nga 01.01.2025 deri më 31.12.2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Kadastrës, Jovan Mirković (*Jovan Mirković*).

**Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët e Kuvendit: Lumnije Gashi dhe Albert Vllahu, Janë të pranishëm 18 këshilltarë dhe ka kuorum.**

Drejtori i Drejtorisë së Kadastrës, Jovan Mirković, tha se ai e mori detyrën si drejtor më 19 shkurt. Në raportin e tij shpjegues, ai theksoi si në vijim: “Gjatë vitit 2025, patëm 943 kontrata për shitblerje. Sa i përket fletës poseduese dhe kopjes së planit, kemi lëshuar 3,202 dokumente. Janë regjistruar 58 ndryshime të kulturës së tokës dhe matjet e objekteve, si dhe 154 vendime për trashëgimi. Gjithashtu, janë lëshuar 116 vendime dhe njoftime të Agjencisë Kadastrale, janë kryer 37 procedura për legalizimin e objekteve si dhe 119 këmbime të parcelave. Sa i përket raportit financiar, janë realizuar gjithsej 84.612 euro, duke u bazuar në bartjen e pronësisë, lëshimin e fletave poseduese dhe kopjeve të planeve, si dhe procedurat për ndarjen dhe bashkimin e parcelave”.

Kryesuesi i Kuvendit dhe këshilltari Ljubisha Karaxhiq i dhanë mbështetjen e tyre të plotë drejtorit të ri të Kadastrës, duke thënë se presin që nëse vazhdohet me këtë ritëm të ketë një ulje të ndjeshme të numrit të përgjithshëm të kërkesave të pazgjidhura.

Kryesuesi pyeti se si qëndron Drejtoria e Kadastrës me personel, pasi ata e dinë se në periudhën e mëparshme kanë pasur vështirësi me mungesën e Shërbimit juridik.

Drejtori i Drejtorisë së Kadastrës, Jovan Mirković, u përgjigj se krahasuar me mandatin e drejtorit të mëparshëm, ai tani është në një pozitë më të mirë, sepse drejtori i mëparshëm është rikthyer në punën e tij si jurist. Puna e Kadastrës është intensifikuar në muajt e fundit dhe se vetëm gjatë muajit të kaluar janë zgjidhur rreth 440 lëndë, por do të ishte e rëndësishme për ne të ricaktonim një punonjës tjetër në Drejtorinë e Kadastrës.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).

Kryesuesi shpjegoi se gjatë vitit 2025, Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti gjithsej 12 mbledhje, nga të cilat 10 ishin të rregullta, 1 ishte e jashtëzakonshme dhe 1 ishte urgjente. Më pas ai i lexoi disa nga propozimet e vendimeve më të rëndësishme që u diskutuan nga Komiteti dhe u miratuan në mbledhjet e Kuvendit të komunës gjatë vitit 2025.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës dhe realizimit të planit të punës së KK të Graçanicës për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).

Kryesuesi shpjegoi se Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka 19 këshilltarë për një mandat 4-vjeçar. Përbërja e subjekteve politike të këshilltarëve të Kuvendit të komunës të mandatit 2021/22 -2025, pas formimit të tij ishte: 18 këshilltarë “LISTA SERBE” dhe 1 këshilltar “Aleanca Shqiptare”. Përbërja e subjekteve politike të këshilltarëve të Kuvendit të komunës të mandatit 2025/26 -2029, pas formimit të tij në mbledhjen konstituive të Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 05.12.2025, është: 13 këshilltarë “LISTA SERBE”, 4 këshilltarë “Aleanca Shqiptare” dhe 2 këshilltarë “PËR LIRI, DREJTËSI DHE MBIJETESË”. Kuvendi i Komunës së Graçanicës në vitin 2025 mbajti gjithsej 14 mbledhje, nga të cilat: 10 të rregullta, 2 të jashtëzakonshme, 1 urgjente dhe 1 mbledhje konstituive. Në mbledhjet e Kuvendit u miratuan gjithsej 64 akte, nga të cilat: 62 vendime; 1 Rregullore nr.01-2025-KG për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, 1 kërkesë drejtuar Qeverisë së Kosovës. Pastaj ai i lexoi disa nga vendimet më të rëndësishme të marra në mbledhjet e Kuvendit të komunës gjatë vitit 2025.


**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Të ndryshme.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:22.

Procesmbajtësi  
Agron Karadollami





Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës

  
Milan Dimitrijević